



PROCEDURAT  
E PLOTËSIMIT TË POZICIONEVE  
TË PUNËS PJESË E SHËRBIMIT CIVIL  
(PJESA E TRETË)

**Ngritja  
në detyrë**

 04 226 8141

 [kms hc@kms hc.al](mailto:kms hc@kms hc.al)

 Rruga "Abdi Toptani",  
Tiranë

## Kur aplikohet procedura e ngritjes në detyrë?

Në rastet kur një vend vakant në kategorinë e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse shpall procedurën e ngritjes në detyrë.

Në rastin e ngritjes në detyrë, kjo do të shoqërohet edhe me ndryshim të nivelit të pagës, përgjegjësisë dhe pritshmërisë për performancë. Ngritja në detyrë bëhet me konkurrim ndërmjet nëpunësve civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin institucion apo nga institucione të tjetër të shërbimit civil.

## Kush ka të drejtë të aplikojë për plotësimin e një pozicioni pune në kategorinë e nivelit të ulët apo të mesëm drejtues?

Kanë të drejtë të aplikojnë në procedurën për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë:

- Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin/vendet e lira.
- Nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, nëse plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendet e lira.